



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 115 / Prot.
19

Tiranë më 22 / 07 / 2021

VENDIM

Nr. 24, datë 22 .07 .2021

“Për miratimin paraprak të tarifave të regjistrimit dhe shkollimit për programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, për vitin akademik 2021-2022”

Bazuar në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” në nenin 3 pika 3 gërma ç), nenin 38 pikat 1 dhe 3, neni 98 pika 2 gërma c); VKM Nr. 288, datë 21.5.2018 “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”; Statutin e Universitetit të Tiranës neni 7, pika 3, gërma ç), neni 31, gërma u), si dhe në propozimin e Administratorit të UT-së të mbështetur në propozimet e njësive kryesore, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës **22.07.2021**;

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të tarifave të regjistrimit për programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, për vitin akademik 2021-2022, të jenë si më poshtë:
 - I. Tarifa e regjistrimit në shumën 1600 lekë.
 - II. Tarifa e regjistrimit për programet e dyta të studimit në shumën 3000 lekë.
 - III. Tarifa e regjistrimit për transferimin e studimeve në shumën 3000 lekë.
2. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që regjistrohen në vitin e parë të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë për vitin akademik 2021-2022, do të jetë sipas tabelës 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Studentët brenda kohëzgjatjes normale të programit të studimeve, i nënshtrohen vetëm një tarife vjetore shkollimi, atë të vitit përkatës.
4. Studentët në programin e studimit të ciklit të parë Bachelor paguajnë tarifë shkollimi për tre vite akademike, të ndarë në vite (sa kohëzgjatja e programit mësimor). Studentët në programin e integruar të studimeve të ciklit të dytë paguajnë tarifë shkollimi për pesë vite akademike, të ndarë në vite (sa kohëzgjatja e programit mësimor).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

5. Vendimi t'i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit të Tiranës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Prof. Dr. Artan Hoxha

